



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 279/1 Prot.

Tiranë, më 17 / 02 / 2020

V E N D I M

Nr. 17, Datë 17 / 02 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 115, datë 17.09.2019, të D.B, e përfaqësuar nga L.B¹ kundër Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë², në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar³”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues në mes të tjerash ka shprehur shqetësimin për mosveprimin e organeve kompetente shtetërore, sa i takon shkeljeve ligjore dhe ndërhyrjeve të kundraligjshme në ndërtim të kryera në pallatin ku ajo banon, në rrugën “M.....E..... D.....” të ndërtuar nga ana e firmës “K..... Construction” shpk. Ankuesja ka informuar se pavarësisht marrëveshjeve noteriale që ajo ka lidhur dhe në kundërshtim me projektin e miratuar, firma e ndërtimit ka shkatërruar rampën e hyrjes me konstruksion metalik të pallatit dhe e ka kthyer hapësirën korresponduese në dyqan, në mënyrë që të përfitojë sipërfaqe shtesë. Mospasja e rampës metalike ka sjellë pasoja shumë të rënda dhe izolimin e plotë të ankueses, si një e sëmure paraplegjike. Referuar dokumentacionit, rezulton se IMT-ja e Bashkisë Tiranë ka kryer verifikimet në terren dhe ka mbajtur procedurën ligjore, duke nxjerrë ndaj ndërhyrjes së

¹ L.B është babai dhe përfaqësuesi ligjor i D.B, i pajisur me prokurën e përgjithshme, Nr. 2799 Rep, Nr. 2543 Kol, datë 04.09.2012.

² Referuar pretendimit të subjektit ankues, datë 20.09.2019.

³ Referuar Librezës së Identitetit Nr. 01572, D.B është përfituese e Statusit të Invalidit, Paraplegjik-Tetraplegjik.

kundërligjshme, aktet: - Proces-verbal konstatimi, Nr. 010116, datë 08.04.2016 dhe - Vendim për prishje me numër serie, nr. 5756, datë 08.04.2016. Subjekti ankues shprehet se dhe pas interesimit për zbatimin e këtij vendimi, IMT-ja e Bashkisë Tiranë dhe pas kaq vitesh nuk ka ndërmarrë veprime për të zbatuar vendimin që ka marrë vetë. Mosveprimi i IMT-s së Bashkisë Tiranë për zbatimin e vendimit të sipërcituar, ka cënuar dukshëm cilësinë e jetës së ankueses, duke e bërë banesën e saj të paaksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe zbatimin e Vendimit për prishje me numër serie, nr. 5756, datë 08.04.2016 të IMT-s së Bashkisë Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 115, datë 17.09.2019, të D.B kundër Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1465, datë 26.09.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë, duke vënë në dijeni dhe Bashkinë Tiranë, për ankesën e bërë nga L.B si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të proces-verbal konstatimi, Nr. 010116, datë 08.04.2016 të IMT të Bashkisë Tiranë.
 - Kopje të Vendimit për prishje me numër serie: Nr. 5756, datë 08.04.2016 të IMT të Bashkisë Tiranë.
 - Kopje të procedurave të ndjekura deri më sot për zbatimin e Vendimit për prishje Nr. 5756, datë 08.04.2016 të IMT të Bashkisë Tiranë.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR897006102AA dhe RR898538819AA, rezulton se IMT-ja e Bashkisë Tiranë dhe Bashkia Tiranë, kanë marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar si nga punonjësi i institucioneve të mësipërme ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

- Në vijim, Komisioneri iu drejtua sërish ITM-së së Bashkisë Tiranë, duke vënë në dijeni dhe Bashkinë Tiranë, me anë të shkresës nr. 1631, datë 24.10.2019.

Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri i bën kujtesë subjektit të sipërpërmendur, për të dërguar informacionin e kërkuar me shkresën nr. 1465, datë 26.09.2019, brenda datës 05.11.2019, duke i sjellë në vëmendje institucionit se mosplotësimi i tij, pengon shqyrtimin e ankesës, si dhe përbën shkelje të dispozitave ligjore të LMD-së.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR894454398AA dhe RR896323758AA, rezulton se IMT-ja e Bashkisë Tiranë dhe Bashkia Tiranë, kanë marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar si nga punonjësi i institucioneve të mësipërme ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

Pas kryerjes së hapave të mësipërm proceduralë, Komisioneri ka çmuar se:

- Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe informacion mbi mosveprimin e institucionit të IMT-së të Bashkisë Tiranë, sa i takon shkeljeve ligjore dhe ndërhyrjeve të kundraligjshme në ndërtim, të kryera në pallatin, në rrugën “M.... E..... D.....”, të ndërtuar nga ana e firmës “K..... Construction” sh.p.k. Komisioneri ka konstatuar se IMT e Bashkisë Tiranë me dijeninë e plotë nuk ka ofruar bashkëpunim dhe nuk ka dhënë informacionin dhe shpjegimet e kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim.

Me shkresën nr. 1770/1, datë 20.11.2019, Komisioneri ka njoftuar IMT-në e Bashkisë Tiranë me Vendimin nr. 172, datë 20.11.2019, në të cilin institucioni i IMT-së, bazuar në nenin 33/13 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është gjobitur në vlerën 100.000 lekë, për mosdhënie informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me shtyrimin e çështjes së L.B.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 115, datë 17.09.2019, Komisioneri me shkresën nr. 1845, datë 04.12.2019, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 12.12.2019, duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve të kërkuara me shkresat e mëparshme.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, L.B dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, IMT-së së Bashkisë Tiranë e përfaqësuar nga A.N, E.C dhe I.A.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, pala ankuese i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Nga ana e përfaqësuesve të IMT-së së Bashkisë Tiranë, fillimisht u prezantua procedura dhe baza ligjore e procesit të prishjes së ndërtimeve të kundraligjshme, si dhe u deklarua se në periudhën në vijim, do të kryhet ndërhyrja për prishjen e ndërtimit të paligjshëm.

Me shkresën nr. 44481/2, datë 02.12.2019, të administruar pranë Komisionerit me nr. 1770/2, datë 19.12.2019, IMT-ja e Bashkisë Tiranë vuri në dispozicion të Komisionerit dokumentacionin e kërkuar, si dhe informoi Komisionerin se, IMT-ja do të ndërhyjë për ekzekutimin e Vendimit për prishje, brenda një periudhë 1 (një) mujore.

Me shkresën nr. 1970/1, datë 26.12.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar IMT-në e Bashkisë Tiranë për Vendimin nr. 196, datë 26.12.2019 në të cilin ka vendosur shfuqizimin e Vendimit me gjobë nr. 172, datë 20.11.2019, pasi mori në dispozicion dokumentacionin e kërkuar.

Në datë 30.12.2019, përfaqësuesja e IMT-së së Bashkisë Tiranë ka dërguar pranë inspektorit të çështjes, disa foto të veprimeve të punonjësve të IMT-së për prishjen e objektit të kundraligjshëm.

Subjekti ankues, në datë 04.02.2020 në mjediset e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, deklaroi⁵ se IMT-ja e Bashkisë Tiranë ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për

⁵ Referuar Procesverbalit datë 04.02.2020, të mbajtur mes L.B dhe inspektorit të çështjes.

prishjen e ndërhyrjes së kundraligjshme në pallatin ku banon vajza e tij dhe ka konsideruar si të zgjidhur problematikën e ngritur në ankesën drejtuar Komisionerit.

Neni 33, pika 9 e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesa e L.B është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të zbatimit të vendimit për prishje me numër serie: Nr. 5756, datë 08.04.2016 të IMT-së së Bashkisë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe nenit 90, pika 2 dhe 3 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur, lidhur me shqyrtimin e ankesës së D.B, e përfaqësuar nga L.B, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA